



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Limitproject" Sh.P.K. të datës 22.04.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA 06/2021" me nr. të prokurimit 616-24-3272-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Limitproject" Sh.P.K. e datës 22.04.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA 06/2021" me nr. të prokurimit 616-24-3272-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të ngarkoj në eprokurim versionin në gjuhën angleze të paramasës.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Limitproject" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Limitproject" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 22.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA 06/2021" me nr. të prokurimit 616-24-3272-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- "Mungon paramasa dhe kërkesat teknike në gjuhën angleze".

Përmes nenit 13 par. 2 të LPP është përcaktuar se "Autoriteti kontraktues do ti përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpjen drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë të madhe në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze".

Përmes sistemit eprokurimi është konstatuar se paramasa nuk është ngarkuar në gjuhën angleze. Prandaj në këtë pikë pretendimi ankimor është i bazuar. Ndërsa nga analizimi i njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit është gjetur se kërkesat teknike janë të bashkangjitura në gjuhë angleze prandaj në këtë pikë pretendimi është i pabazuar.

Technical and/or professional capability requirements	9.1 & 9.2	Technical and professional capacity:	Documentary evidence required:
		1. The economic operator must provide proof that he has successfully completed at least two projects for Smart public lighting (SCADA) according to article 5 point 1.4 of UA(ME) No. 06 2021, worth no less than €2,000,000.00.	1. A list of completed completing Annex 6 of the Te where the title of the cont amount of the contract, the start the end date and the beneficiary specified, as well as the refer certificates for the performan works must be attached to the li
		2. The economic operator must provide evidence that they have successfully completed contracts for energy services of the ESCO model in public lighting, according to article 4 point 2.3 as well as article 5 point 1.1 of UA(ME) No. 06 2021. The value of the contracts must be no less than €5,000,000.00.	
		3. The economic operator must have at least 2 references in the Energy Audit for public lighting according to UA(ME) No. 06 2021.	. Copy of references from an end for public lighting according to No. 06 2021

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.04.2024



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.